

NJOFTIM PËR MARRJEN PJESË NË TRYEZAT E DISKUTIMIT DHE TË KËSHILLIMIT, NË KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN

Në kuadër të procesit të integrimit evropian, Ministria e Arsimit fton të marrin pjesë lirisht në tryezat e diskutimit dhe të këshillimit, të cilat krijohen në mënyrë analoge me kapitujt e acquis të Bashkimit Evropian, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, të botës akademike, të medias dhe të grupeve të interesit.

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 113, datë 30.8.2019, *“Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për integrimin evropian”*, Ministria e Arsimit në cilësinë e institucionit drejtues të:

- Kapitulli 25 “Shkenca dhe Kërkimi Shkencor”
- Kapitulli 26 “Arsimi dhe Kultura”

Referuar përcaktimeve të kreut III.2, pika 4, të urdhrit. Sipas përcaktimeve të kreut III.2, të urdhrit të Kryeministrit, aplikimi për t’u bërë pjesë e tryezave të diskutimit dhe të këshillimit kryhet nëpërmjet dorëzimit (e-mail ose pranë MA) të një letre interesi, si dhe CV-së së personit apo të grupimit që përfaqëson, duke treguar se kanë ekspertizën apo interesin e mjaftueshëm për të kontribuar në tryezat specifike.

Personat apo përfaqësuesit e grupeve të interesit mund të paraqesin dokumentacionin e sipërcituar për pjesëmarrje, brenda datës **19.04.2026**, ku të jenë specifikuar eksperiencat e mëparshme si dhe ekspertiza specifike që mund të ofrohet për procesin e integrimit evropian dhe konkretisht lidhur me fushat që mbulon, në adresat e mëposhtme elektronike të sekretariateve teknike të GNPIE-së, sipas kapitujve më poshtë:

Kapitulli 25 “Shkenca dhe Kërkimi Shkencor”, enela.duro@arsimi.gov.al;

Kapitulli 26 “Arsimi dhe Kultura”, brikena.kollcinaku@arsimi.gov.al.

Përzgjedhja e personave apo e përfaqësuesve të grupeve të interesit do të bëhet, sipas urdhrit të Kryeministrit nr. 113, datës 30.08.2019.